



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni Pranvrer

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 06/2010

Prishtinë më 09. 02. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjës së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Nerxhivane Dauti, Fatmir Rexhepi, Zef Morina, dhe Qamile Morina.

Munguan: Slobodan Petroviq, Sala Berisha – Shala, Kaqusha Jashari, dhe Múfera Şinik.

Pjesëmarrës tjerë: Visar Ramaj – KDI, Besim Zeqiri - ICO, dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent i Komisionit.

Stafi Mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i Procesverbalit të datës 02.02.2010 dhe 05.02.2010;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Shërbime postare ;
- 4 .Miratimi i Planit të punës për vitin 2010;
- 5.Të ndryshme ;

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve më 02.02. 2010 dhe 05. 02. 2010

Kryetarja e Komisionit konstatoi se miratohen procesverbalet e mbledhjeve më 02. 02. 2010 dhe 05. 02. 2010 pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i Projektligjit për Shërbime postare

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit se kryesuesi i Grupit punues për Projektligjin për Shërbime postare, Zef Morina, paraqet Raportin me amendamente.

Zef Morina – theksoj se Grupi punues e ka shqyrtuar Projektligjin për Shërbime postare dhe ka propozuar amendamentet, të cilat i paraqiti për diskutim te cilat ne vazhdim u shqyrtuan nen për nen

Amendamenti 1 ndryshon Nenin 3; Amendamenti 2 ndryshon Nenin 4; Amendamenti 3 ndryshon Nenin 5; Amendamenti 4 ndryshon Nenin 6; Amendamenti 5 ndryshon Nenin 7; Amendamenti ndryshon Nenin 9; Amendamenti 7 ndryshon Nenin 10; Amendamenti 8 ndryshon Nenin 11; Amendamenti 9 ndryshon Nenin 12; Amendamenti 10 ndryshon Nenin 13; Amendamenti 11 ndryshon Nenin 14; Amendamenti 12 ndryshon Nenin 15; Amendamenti 13 ndryshon Nenin 21; Amendamenti 14 ndryshon Nenin 24; dhe Amendamenti 15 ndryshon Nenin 27.

Nerxhivane Dauti dhe Ethem Çeku - ishin te pajtimit që te hiqet amendamenti “nënkupton” nga Projektligji jo vetëm nga ky po ne te gjitha Projektligjet. Pasi qe ky vendim është propozuar nga Komisioni për Legjislacion dhe miratuar ne seance plenare.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Më vërejtjen e cekur Amendamentet u miratuan në tërësi
- II. Shqyrtimi i Raportit vazhdohet në mbledhjen e radhes.

IV. Miratimi i Planit dhe programit të punës për 2010

Kryetarja- theksoj pasi që ne ketë pikë të rendit të ditës është Raportuese znj. Nerxhivane Dauti, të cilës ia dha fjalën.

Nerxhivane Dauti - theksoj se Plani dhe Programi i punës është hartuar më një kujdes të

veçantë, të cilin e cilësoj si mjaftë konciz dhe të detajuar. Po ashtu njoftoi se ky Plan dhe Program i Punës për vitin 2010, është hartuar në bazë të Strategjisë Legjislative të Qeverisë dhe si Komision Funkcional do të duhej një orientim më i drejtë që të përshtatej punës sipas Planit dhe Programit.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Miratohet Plani dhe Programi i Punës për vitin 2010

V. Të ndryshme

a) Raportimi për Autoudhën Vërmicë – Merdare

Kryetarja – theksoj se edhe pas disa përpjekjeve të vazhdueshme për të sjellë ministrin Limaj, në Komision, kjo gjë ishte e pamundur. Andaj duhet të presim deri pas datës 16 shkurt 2010, të caktohet një takim për të shtjelluar këtë çështje.

b) Plani i Veprimit i Kuvendit

Kryetarja – kërkoj të formohet një Grup Punues për ta hartuar Propozim Planin e Veprimit për Integritime Evropiane, në bazë të kërkesës së Komisionit për Integritime Evropiane, që në Komision ta mbulojmë fushën tonë dhe ta hartojmë një Raportë. Në këtë Grup Punues propozoj që caktohet znj. Nerxhivane Dauti.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Grup Punues për të hartuar Planin e Veprimit për Integritime Evropiane të udhëhiqet nga znj. Nerxhivane Dauti.

c) Mbledhja e radhës

Kryetarja – kërkoj që në mbledhjen e radhës të jetë si pikë e rendit të ditës të jetë në shqyrtim Projektligji për shërbimet postare.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Mbledhja e radhës caktohet më datë 16.02.2010
- II. Në shqyrtim të jetë vazhdimi i shqyrtimi i Raportit më amendamente të Projektligjit për shërbimet postare.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetarja e Komisionit
Myzejene Selmani**